

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6359
E premte, 9 korrik 2021
çmimi 0.40 €

Gjenerali Clark: Ali Ahmeti është legjendë e vërtetë

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

SHBA-ja DHE KOSOVA KËRKOJNË NGA SERBIA DREJTËSI PËR VËLLEZËRIT BYTYQI

FAQE 4-5

SHBA-ja DHE KOSOVA KËRKOJNË NGA SERBIA DREJTËSI PËR VËLLEZËRIT BYTYQI



Departamenti Amerikan i Shtetit dhe Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Serbi kanë kërkuar drejtësi për vëllezërit Bytyqi. Ambasada amerikane ka theksuar se rasti i tre vëllezërve Bytyqi, Yllit, Agronit dhe Mehmetit, ilustron nevojën urgjente që Serbia t'i hetojë rastet e pazgjidhura të krimeve të luftës dhe të fokusohet në fuqizim të sundimit të ligjit. Edhe nga Kosova kanë kërkuar drejtësi për vëllezërit Bytyqi

OSMANI DHE KURTI NGUSHËLLOJNË KADRI VESELIN, HARADINAJ NDERON BABANË E TIJ

FAQE 5



KRYEDIPLOMATJA E SUEDISË SHPALOS NË KOSOVË PRIORITETET E OSBE-së

FAQE 3

EKONOMI



BESNIK BEQIRI ZGJEDHET PRESIDENT I BORDIT TË OEGJK-së

F. 8

KRU "PRISHTINA" ZBULON DHJETËRA KYÇJE ILEGALE DHE NDËRHYRJE NË RRJETIN E UJËSJELLËSIT

F. 8

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ndërpriten kërkimet për të mbijetuarit në Florida

FLORIDA, 8 KORRIK - Ekipet e shpëtimit kanë përmbyllur kërkimet për të mbijetuarit nën rrënojat e një ndërtese në Florida e cila është rrëzuar gati dy javë më parë. "Në këtë pikë ne kemi shfrytëzuar secilën mundësi në misionin tonë të kërkim-shpëtimit. Fokusi ynë tani do të bartet në nxjerrjen e trupave të viktimave nga rrënojat", ka thënë kryetarja e qarkut Miami-Dade, Daniella Levine Cava.

Ndërtesa në zonën Surfside është rrëzuar në orët e para të 24 qershorit.

Numri i viktimave deri më tani ka shkuar në 54, ndonëse për 86 persona nuk dihet ende asgjë.

Asnjë i mbijetuar nuk është gjetur pas rrëzimit të ndërtesës, derisa ekipet e shpëtimit kanë thënë se shumë viktime, që janë gjetur nëpër rrënoja, kanë qenë ende nëpër shtretër.

Hetuesit ende nuk kanë

vërtetuar se çfarë ka shkaktuar rrëzimin e ndërtesës 40-vjeçare.

Në një raport të inxhinierëve më 2018 janë gjetur disa parregullsi në strukturë të ndërtesës, të cilat tani janë në qendër të hetimeve.

Pas rrëzimit të ndërtesës, zyrtarët në qytete të tjera kanë nisur të kontrollojnë edhe ndërtesa të tjera në afërsi, për t'u siguruar se nuk ka probleme të tilla në strukturë.



Bota regjistron mbi katër milionë viktime nga Covidi



GJENEVE, 8 KORRIK - Mbi katër milionë persona në mbarë botën kanë vdekur nga Covid-19 ka bërë me dije Organizata Botërore e Shëndetësisë (OSh), ndonëse shifra zyrtare besohet se është më e vogël sesa numri i viktimave nëpër botë.

Shumë shtete janë duke raportuar për trendë shqetësues teksa varianti "Delta" i koronavirusit vazhdon të përhapet, duke shtyrë disa vende në Azi që t'i rikthejnë masat kufizuese, ndërkohë që shtetet e pasura po hapen. "Bota është në një pikë të

rezikshme në këtë pandemi", ka thënë shefi i OSh-së, Tedros Adhanom Ghebreyesus.

Japonia pritet ta nisë zbatimin e masave të reja kundër koronavirusit, duke përfshirë shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme në Tokio, vetëm disa javë para nisjes së Lojërave Olimpikë Verore.

Organizatorët do të takohen më 8 dhe 9 korrik për ta shqyrtuar mundësinë e ndalimit të spektatorëve në këto lojëra, pasi ka shqetësime se numri i madh i atletëve dhe turmave të mëdha mund ta rritin shkallën e infektimit.

Policia vret katër persona pas sulmit vdekjeprurës ndaj presidentit të Haitit

PORT-AU-PRINCE, 8 KORRIK - Policia në Haiti ka njoftuar se ka vrarë katër "mercenarë" të dyshuar dhe ka zënë dy të tjerë pas vrasjes së presidentit të këtij shteti në shtëpinë e tij më 7 korrik.

Sipas zyrtarëve policorë, të dyshuarit e tjerë janë në arrati. Vrasja e presidentit 53-vjeçar Jovenal Moise mund të krijojë sfida të reja dhe kërcënon ta përballë me kaos shtetin me 11 milionë banorë.

Kryeministri i përkohshëm, Claude Joseph, ka shpallur "shtetërkthim kombëtar" dhe ka thënë se ai tani do ta udhëheqë shtetin. Ende nuk ka të dhëna se kush ka qenë mbrypa sulmit kundër

presidentit, ndonëse është raportuar se disa burra, që kanë pretenduar se janë "zyrtarë policorë amerikanë për hetime të drogës", kanë hyrë në shtëpinë e Moise.

Zonja e Parë e Haitit, Martine Moise, është në gjendje kritike shëndetësore dhe është raportuar të jetë dërguar në Florida për trajtim.

Moise ka marrë pushtetin përmes një dekreti, pasi zgjedhjet më 2018 ishin shtyrë. Shkarkimet politike dhe veprimet e tjera kanë qenë tejet të shpeshta pak para mbajtjes së zgjedhjeve të përgjithshme, më vonë gjatë këtij viti.

Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara ka dënuar vrasjen



dhe ka bërë thirrje që kryesit e vrasjes të përballen me drejtësinë. Opozita në Haiti ka

akuzuar Moisen se ka instaluar sistem të diktaturës, duke zgjatur mandatin e tij dhe

duke u bërë më autoritar. Ai, në anën tjetër, ka mohuar akuzat.

KE-ja ndan 6.3 miliardë euro për rimëkëmbjen e Kroacisë

BRUKSEL, 8 KORRIK - Komisioni Evropian ka miratuar fondin prej 6.3 miliardë eurosh për Kroacinë në mënyrë që ky vend ta ringjallë rritjen ekonomike të dëmtuar nga pandemia e koronavirusit. Mjetet financiare janë pjesë e një

pakoje financiare në vlerë 800 miliardë euro të cilën BE-ja e ka miratuar për rimëkëmbjen ekonomike të 27 vendeve anëtare.

Komisioni Evropian tha se Kroacia ka në plan që këto fonde

t'i përdorë për çështje të problemeve që ndërlidhen me ndryshimet klimatike, për restaurimin e lumenjve dhe të liqeneve dhe për mbrojtjen nga përmbytjet.

Një pjesë e fondit do të

shpenzohet për rindërtimin e ndërtesave private dhe publike të dëmtuara nga tërmeti që goditi këtë vend në fund të vitit të kaluar.

Që nga viti 2013 Kroacia është shteti më i ri anëtar i BE-së.



Gjenerali Clark: Ali Ahmeti është legjendë e vërtetë

SHKUP, 8 KORRIK - Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, ka pritur në takim ish-komandantin e lartë të NATO-së, gjeneralin Wesley Clark. Ai ka thënë se miqtë dhe aleatët tanë, siç është ShBA-ja, "gjithmonë kanë qenë forca e cila na ka mbështetur në kohët më të vështira e, gjithashtu, edhe në çastet më të mira të popullit tonë".

Më tutje, Clarku i ka thënë Ahmetit se ka pasur rol legjendar për ndërtimin e këtij shtetit dhe se Ahmeti është një legjendë e gjallë. "Keni pasur rol legjendar në ndërtimin e këtij shteti, ju z. Ahmeti jeni një legjendë e vërtetë. Keni ndërtuar një parti e cila po shndërrohet në kurriz të stabilitetit të vendit. Transformimi fasciuës për këtë vend që mund të përfundonte në jostabilitet, u bë një shtet i fuqishëm i stabilitetit", është ka thënë Clarku.

Kryetari Ahmeti dhe gjenerali Clark kanë biseduar edhe për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO,

ndihmën që Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kanë dhënë në këtë drejtim, rolin konstruktiv të vendit, ndërtimin e shoqërisë së barabartë si dhe sfidat që vendi i ka në rrugën e integritit në Bashkimin Evropian.

Clarku kishte një rol të veçantë në misionin e tij për vendosjen e paqes në Ballkan. Me këtë rast, Ahmeti e ka falënderuar gjeneralin dhe NATO-n, duke theksuar se të gjitha të arriturat janë të përbashkëta dhe se si vend e si popull jemi përjetësisht mirënjohës ndaj tyre.

Krejt në fund, gjenerali Clark ka theksuar se Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbështesin fuqishëm progresin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në shumë sfera, përfshirë këtu edhe zhvillimin ekonomik, për një të ardhme më të mirë të vendit. Në fund të takimit është vlerësuar se NATO-s nuk do t'i harrohet asnjëherë kontributi që e ka dhënë për shpëtimin e vendit nga tragjedia. Gjenerali Clark ka qëndruar të mërkurën edhe në Kosovë.



Kryediplomatja e Suedisë shpalos në Kosovë prioritetet e OSBE-së

PRISHTINË, 8 KORRIK (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur në takim kryesuesen e OSBE-së dhe ministren e Jashtme të Suedisë, Ann Linde, me të cilën ka biseduar për rolin e OSBE-së në Kosovë dhe për bashkëpunimin e mëtejshëm me këtë organizatë. Në këtë vizitë, Linde ishte e shoqëruar edhe nga Asa Regner, zv/drejtoreshë e UN Women. Në fokus të kësaj vizite ishte edhe çështja e fuqizimit të vajzave dhe grave në fushën e sigurisë dhe në procese të paqes. Presidentja Osmani ka theksuar mirënjohjen për rolin që kjo organizatë e ka luajtur në Kosovë në vitet '90 nëpërmjet misionit të saj vëzhgues, por edhe pas luftës, në forcimin e institucioneve. Ajo ia ka paraqitur ministres Linde synimin e institucioneve që t'i thellojnë raportet me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare siç është OSBE-ja. "Prioriteti ynë është bashkëpunimi me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare, si dhe anëtarësimi sa më i shpejtë i vendit tonë në to, ngaqë kësaj do të përfitonin të gjithë qytetarët e vendit", ka thënë Osmani.

Më tutje, Osmani i ka kërkuar ministres Linde që Suedia, si vend udhëheqës i OSBE-së, të ndikojë që raportet e Kosovës me këtë organizatë të avancohen. Ndërsa udhëheqësja e OSBE-së ia ka paraqitur presidentes Osmani prioritetet të cilat vendi i saj do t'i ndjekë gjatë kohës sa do të udhëheqë këtë organizatë.



Në takim palët kanë diskutuar edhe për forcimin e sigurisë dhe të paqes, në veçanti për pjesëmarrjen e grave në politikën e sigurisë.

Në këtë takim është vlerësuar lart fakti që Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka votuar unanimisht përfshirjen e Konventës së Stambollit në Kushtetutë. Duke vepruar në këtë mënyrë, palët kanë theksuar se Kosova është paraqitur si një vend që e kupton qartë rëndësinë e angazhimit drejt parandalimit të dhunës ndaj grave dhe të dhunës familjare, si dhe mbrojtjes së viktimave.

Presidentja Osmani ka potencuar që përtej këtij hapi të rëndësishëm, Kosova ka nevojë për mbështetje drejt zbatimit të kësaj konvente duke kërkuar që të identifikohen modalitetet e bashkëpunimit konkret në këtë drejtim.

Palët e kanë vlerësuar gatishmërinë e Kosovës për të punuar ngushtë

me OSBE-në dhe UN Women në forcimin e rolit të gruas në jetën publike, përfshirë edhe institucionet e sigurisë.

Edhe ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Republikës së Kosovës, Donika Gërvalla, ka pritur në takim ministren e Jashtme të Suedisë, njëherësh kryesuese e radhës së OSBE-së, Ann Linde. Ky takim është zhvilluar në kuadër të angazhimit të Suedisë si kryesuese e OSBE-së. Homologet kanë pasur rastin të shkëmbejnë mendime edhe për çështje bilaterale në mes të Kosovës dhe Suedisë.

Palët kanë diskutuar për prioritetet e Suedisë në kuadër të kryesimit të OSBE-së, duke vendosur theksin në konceptin gjithëpërfshirës dhe qasjen shumëdimensionale që ndërthur çështje që lidhen me sigurinë politike, ekonomike, të drejtat e njeriut dhe demokracinë.

Duke folur për agjendën e grave, kryediplomatja Linde ka vlerësuar se Kosova është shembull i mirë i përfaqësimit të grave në pozita udhëheqëse duke përmendur pozitën e presidentes, ministreve e deputetëve.

Ndërsa ministria Gërvalla ka

theksuar nevojën për inicim të projekteve të veçanta për ta zbutur papunësinë, sidomos të grave. Në këtë drejtim e njoftoi homologen e saj me përpjekjet e Qeverisë së Kosovës për të krijuar një klimë të përshtatshme për tërheqje të investimeve që do të mundësonin hapje të vendeve të reja të punës. Në takim është theksuar edhe nevoja që të trajtohen me seriozitet çështjet që lidhen me sundimin e ligjit, lirinë e medias si dhe nevoja për reformë zgjedhore.

Nga ana tjetër, sa i përket bashkëpunimit bilateral në mes të Kosovës dhe Suedisë, kryediplomatet kanë biseduar për marrëdhëniet e shkëlqyeshme në mes të dy vendeve. Me këtë rast, ministria Gërvalla ka theksuar se Kosova është shumë mirënjohëse për miqësinë dhe mbështetjen e madhe të shtetit të Suedisë në të gjitha fushat.





ShBA-ja dhe Kosova kërkojnë nga Serbia drejtësi për vëllezërit Bytyqi

Departamenti Amerikan i Shtetit dhe Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Serbi kanë kërkuar drejtësi për vëllezërit Bytyqi. Ambasada amerikane ka theksuar se rasti i tre vëllezërve Bytyqi, Yllit, Agronit dhe Mehmetit, ilustron nevojën urgjente që Serbia t'i hetojë rastet e pazgjidhura të krimeve të luftës dhe të fokusohet në fuqizim të sundimit të ligjit. Edhe nga Kosova kanë kërkuar drejtësi për vëllezërit Bytyqi

BEOGRAD, 8 KORRIK - Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Serbi ka deklaruar se rasti i tre vëllezërve Bytyqi, Yllit, Agronit dhe Mehmetit, ilustron nevojën urgjente që Serbia të hetojë rastet e pazgjidhura të krimeve të luftës dhe të fokusohet në fuqizim të sundimit të ligjit. Ambasada e ka bërë këtë deklaratë në përvjetorin e 22-të të vrasjes së vëllezërve Bytyqi, a kanë qenë në mbajtje të policisë speciale të Serbisë.

Trupat e tyre më vonë janë gjetur në një bazë në Petrovo Sello, në lindje të Serbisë, e cila është kontrolluar nga Goran Radosavljeviq - Guri. "Vëllezërit Bytyqi janë ekzekutuar, janë qëlluar në kokë me duar të lidhura mbrapa shpinës, e pas dy dekadave nuk ka hetim të plotë. Ne nuk mundemi dhe nuk do ta harrojmë këtë krim. Sjellja e drejtësisë për vëllezërit Bytyqi dhe familjet e tyre, si dhe mbajtja përgjegjëse e atyre që kanë kryer dhe fshehur vrasjet e tyre, vazhdon të jetë prioritet për marrëdhëniet tona bilaterale me Serbinë", është thënë në reagimin e Ambasadës.

Më 7 korrik Prokuroria për Krime të Luftës në Serbi ka thënë se është duke mbledhur prova të reja me qëllim që të "përcaktohet

identiteti" i autorëve të vrasjes së vëllezërve Bytyqi më 1999.

Agron Mehmeti dhe Yll Bytyqi, shtetas amerikanë, me prejardhje nga Kosova, janë arrestuar në vitin 1999 në Serbi për shkak të, siç kanë thënë zyrtarët serbë, kalimit të paligjshëm të kufirit. Ata janë liruar nga burgu pasi janë dënuar dhe më pas janë vrarë. Trupat e tyre janë gjetur në një varr masiv pranë Petrovo Sellos në lindje të Serbisë në vitin 2001. Në një përgjigje për "Radion Evropa e Lirë", prokuroria serbe ka thënë se vrasja e vëllezërve Bytyqi është në fazën e hetimeve që po zhvillohen kundër "autorëve të panjohur mbi bazën e dyshimit se ishte kryer krim luftime ndaj të burgosurve të luftës". "Problemi në rastin tonë dhe në shumë raste të tjera është se Serbia madhëron dhe mbron kriminelët e luftës", ka thënë Ilir Bytyqi, vëllai i tre shtetasve të vrarë amerikanë, Ylli, Agron dhe Mehmet Bytyqi.

Këto komente të Ilir Bytyqit vijnë pasi Serbia ka nderuar me një medalje mirënjohjeje ish-komandantin e xhandarmërisë serbe, Goran Radosavljeviq-Guri. Përmes një përgjigjeje me shkrim, Ilir Bytyqi, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se "afërsia midis presidentit serb,

Aleksandar Vuçiq dhe qeverisë së tij me kriminelët e luftës, është turp" dhe se kjo "parandalon drejtësinë dhe i privon viktimat që të arrijnë paqe".

"Në vitin 2016 presidenti Vuçiq i premtoi nënpresidentit të atëhershëm Biden (presidentit aktual të Shteteve të Bashkuara) se ai personalisht do të angazhohej për zgjidhjen e vrasjes së vëllezërve të mi. Vuçiqi më pas i tha familjes time dhe zyrtarëve amerikanë se Goran Radosavljeviq ishte përgjegjës për vrasjen e tyre. Për një kohë të gjatë ekzistojnë prova të gjata dhe të mjaftueshme (për këtë)", ka thënë Bytyqi.

Nga Presidencia serbe nuk i janë përgjigjur pyetjes së REL-it nëse Vuçiqi ka folur para zyrtarëve amerikanë për përgjegjësinë e Radosavljeviqit për vrasjen e vëllezërve Bytyqi dhe se çfarë informacionesh ka Vuçiqi për këtë rast. Zyrtarët serbë, të udhëhequr nga presidenti Vuçiq, nuk kanë konfirmuar këto pretendime të Ilir Bytyqit të cilat ai i ka bërë publike para mediave.

Pas raportimit të "Radios Evropa e Lirë" më 30 qershor, se xhandarmëria, në shenjë mirënjohjeje për bashkëpunimin e suksesshëm, i ndau një medalje Radosavljeviqit, që ishte

komandanti i parë i njësisë speciale të xhandarmërisë, ka reaguuar Ambasada e ShBA-së në Beograd. Duke kujtuar se Radosavljeviq ishte në krye të kampit ku u gjetën eshtrat e tre shtetasve amerikanë, Ylli, Agron dhe Mehmet Bytyqi, ambasada tha më 3 korrik se Radosavljeviq "duhet të përballet me drejtësinë dhe nuk duhet të marrë medalje".

Në një postim në "Twitter", Ambasada Amerikane, po ashtu, ka kujtuar se Shtetet e Bashkuara e kishin sanksionuar Radosavljeviqin për përfshirjen e tij në vrasjen e vëllezërve Bytyqi. Edhe zëdhënësi i Departamentit të Shtetit, Ned Price, në 22-vjetorin e vrasjes së vëllezërve Bytyqi, ka kërkuar nga autoritetet e Serbisë që të hetojnë dhe të sjellin para drejtësisë individët që janë përgjegjës për vrasjen e tyre në vitin 1999 në Serbi. "Edhe një herë ne u bëjmë thirrje autoriteteve serbe të hetojnë dhe të sjellin para drejtësisë personat përgjegjës për vrasjet e shtetasve të ShBA-së Agron, Ylli dhe Mehmet Bytyqi në vitin 1999. Shtetet e Bashkuara nuk do të pushojnë së bëri thirrje për një zgjidhje të këtij rasti", ka shkruar Price në llogarinë e vet në "Twitter".

Haradinaj dhe Çitaku kërkon drejtësi për vëllezërit Bytyqi

Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka përkujtuar vëllezërit Bytyqi. Duke vlerësuar lart kontributin e

vëllezërve Bytyqi për lirinë e Kosovës, Haradinaj ka thënë se nuk do të ndalen se kërkuari drejtësi për ta. "Agron, Ylli dhe Mehmeti iu bashkuan rreshtit të mbrojtësve të vendit në çastet më vendimtare të luftës për liri. Rënia e tyre shpals dimensionin e vërtetë të kësaj lufte. Shteti serb, përpos që i ekzekutoi pa gjyq, vazhdon injorimin e krimeve dhe dekorimin e kriminelëve të luftës, mes tyre edhe ata që dyshohen se vranë vëllezërit Bytyqi. E dashur familje Bytyqi, sot e çdo ditë ne ndajmë dhembjen me ju dhe me bashkëluftëtarët e 'Atlantikut'. Shpirti i tyre human, atdhedashuria dhe heroizmi i Agronit, Yllit e Mehmetit, do të përkujtohen gjithmonë. Ne kurrë nuk do të ndalemi së kërkuari drejtësi për ta. Lavdi e përjetshme!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe ish-ambasadorja e Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Vlora Çitaku, ka kërkuar drejtësi për vrasjen e vëllezërve Bytyqi nga forcat serbe. Në llogarinë e saj në "Twitter", ajo ka shkruar se edhe 22 vjet pas vrasjesit e këtyre amerikanëve mbeten të pandëshkuar. "Katër vëllezërit praktikuan një short duke tërhequr fije kashte për të vendosur kush qëndron me prindërit, derisa të tjerët shkojnë dhe luftojnë për lirinë. Vëllezërit Bytyqi u ekzekutuan nga forcat serbe pas përfundimit të luftës në Kosovë. 22 vjet më vonë, vrasësit e këtyre amerikanëve mbeten të pandëshkuar!", ka shkruar Çitaku.

Osmani dhe Kurti ngushëllojnë Kadri Veselin, Haradinaj nderon babanë e tij



PRISHTINË, 8 KORRIK (ER) - Të mërkurën i është dhënë lamtumira e fundit babait të Kadri Veselit, bacës Fazli. Kadri Veseli, i cili gjendet në paraburgim në Hagë, nuk është lejuar nga Gjykata Speciale që të marrë pjesë në

ceremoninë mortore të babait të tij 94-vjeçar. Familja Veseli të enjten ka hapur dyert për ngushëllime. Përpos personaliteteve të shumta, Kadri Veseli është ngushëlluar edhe nga presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani. "Ndarja nga jeta e më të



dashurit tuaj, në një kohë të vështirë për familjen, është humbje e madhe për familjen dhe miqtë", është thënë në telegramin e ngushëllimit të presidentes Osmani. Edhe kryeministri i Kosovës, Albin

Kurti, ka shprehur ngushëllime për ndarjen nga jeta të Fazli Veselit, babait të Kadri Veselit. "Me keqardhje të madhe mësova lajmin e ndarjes nga jeta të Fazli Veselit. Në këto çaste pikëllimi, i shpreh ngushëllime ish-kryetarit të

Kuvendit të Kosovës dhe ish-kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, z. Kadri Veseli dhe mbarë familjes Veseli, për vdekjen e familjarit të tyre", është thënë në telegramin e ngushëllimit të Kurtit. Ndërsa kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, së bashku me zyrtarë të kësaj partie, kanë shkuar për ngushëllime në familjen Veseli. Me këtë rast, ai ka nderuar bacën Fazli me medaljen "Me besim në Zot, atdhe dhe shtet". "Fazli Veseli shkoi në botën e përtejme, me një trashëgimi të madhe që e la pas, fëmijët e edukuar e brumosur me atdheadashuri. Për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në çështjen kombëtare i kam ndarë medaljen 'Me besim në Zot, atdhe e shtet'. Sot ndamë dhembjen me familjen Veseli, miqtë e bashkëluftëtarët! Zoti ju forcoftë!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Kosovën e mbrojnë vetëm nëntë avokatë

PRISHTINË, 8 KORRIK - Kur individë ose biznese padisin shtetin e Kosovës, përkatësisht ministrinë, barra për t'u përballur me këto padi në gjykatë, u bie nëntë avokatëve të shtetit. Këta avokatë parashihet edhe të nisin procedura në gjykatë në rastet kur ndonjë ministri konsideron se një kompani apo individ i caktuar, i ka shkaktuar dëm të ndonjë lloji.

Zyra e Avokaturës Shtetërore po përballet me mungesë të madhe të kapaciteteve, derisa mijëra lëndë të reja gjyqësore paraqiten nëpër gjykatat e vendit, shpesh edhe me rrezikun që mijëra euro nga buxheti të humben në këto procese.

Në dhjetor të vitit 2020 u bë me dije se kompania amerikane "ContourGlobal" e ka dërguar shtetin e Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit. Sipas marrëveshjes që Qeveria e Kosovës kishte pasur me këtë kompani për ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re", nëse zvarritet e kontratës me "ContourGlobal" shkaktohen nga Kosova, pra nga mospërmbushja e obligimeve, atëherë Qeveria e Kosovës do të ketë si përgjegjësi financiare ndaj kompanisë "ContourGlobal", një vlerë prej 19.7 milionë eurosh. Në të kundërtën, kjo kompani i detyrohet Kosovës 17.5 milionë euro.

Këtë çështje do ta përfaqësojë në gjykatë Avokatura e Shtetit, së bashku me një kompani ligjore të kontraktuar.

Edhe pse ky gjyq paraqet rrezik të madh për humbjen e miliona eurove, kjo është vetëm një nga mijëra lëndë të cilat, avokatët e paktë të shtetit, duhet t'i mbrojnë e përfaqësojnë. Sipas të dhënave të publikuar nga Avokatura e Shtetit për vitin 2020, vlera monetare e humbjeve si pasojë e proceseve gjyqësore që ishin në disfavor të shtetit të Kosovës ishte 3 milionë e 500 mijë euro, ndërsa vlera monetare e fituar ishte mbi 12 milionë e 800 mijë euro.

Shteti, po ashtu, ka dhënë 15 milionë e 600 mijë euro në shpronësime dhe mbi 3 milionë e 500 mijë euro në procedura të përmbarimit.

Sami Istrefi, avokat i përgjithshëm i shtetit, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se me gjithë vullnetin e madh të punës së këtyre avokatëve, volumi i madh i lëndëve mund të bëjë që jo të gjitha lëndët të trajtohen me gjithë vëmendjen e duhur. Sipas Istrefit, janë mbi 20 mijë lëndë të cilat janë trajtuar nga ky institucion.

Ndërsa sipas raportit të punës së këtij institucioni, vetëm në vitin 2020 janë pranuar 2 170 raste të reja dhe avokatëve gjatë këtij viti u është dashur të përfaqësojnë lëndë në gjykatë në 2 076 seanca. "Nëse tash i marrim dhe e bëjmë një përpjesëtim të mundshëm për avokat të shtetit, është e pamundur që të gjitha këto mund t'i përfaqësojmë denjësisht, duke pasur parasysh ngarkesën e madhe, pa hyrë në lëndët e tjera të cilat janë aktive në gjykatat tona të rregullta", ka thënë Istrefi.

Në anën tjetër, Ehat Miftaraj, drejtor ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Drejtësi, ka pohuar se në monitorimin e proceseve gjyqësore që bëjnë, kanë mundur ta evidentojnë pamundësinë e përfaqësimit të denjë të rasteve nga Avokatura e Shtetit. Sipas tij, kjo ndodh shpesh edhe për shkak të mungesës së bashkëpunimit në mes institucionit, përkatësisht ministrisë së përfshirë në rast dhe Avokaturës së Shtetit.

"Kemi gjetur jo rrallëherë kur nuk ka një bashkëpunim, nuk ka një koordinim në mes të Avokaturës Shtetërore dhe institucioneve apo ministrive përkatëse, për të ofruar mbrojtje sa më profesionale, në mënyrë që lëndët, qoftë të fitohen apo së paku të kenë ekspertizën apo përfaqësimin e duhur në gjykatë", ka thënë ai.

Si funksionon Avokatura e Shtetit?

Në një zyrë jo shumë të madhe brenda objektit të njohur si ish-ndërtesa e Rilindjes kryejnë punën e përditshme avokatët shtetërorë. Përveç drejtorit të kësaj agjencie, Sami Istrefi, ekipin e përbëjnë avokatët: Ilire Aydogan, Arsim Zuka, Naim Krasniqi, Muharrem Kurtaj, Naime Abazi, Fitore Gajtani, Nexhmije Karaqi, Nazmije Aliu dhe Bedri Krasniqi.

Avokatura e Shtetit është një institucion i pavarur që funksionon në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Disa nga detyrat e këtij institucioni përfshijnë: përfaqësimin e ministrisë, qeverisë dhe entiteteve të tjera pranë organeve gjyqësore, pranë arbitrazheve si dhe organeve të tjera administrative; hartimin e parashtresave ligjore, memorandumëve dhe ndonjë dokumenti tjetër që kërkohet në lidhje me përfaqësimin gjyqësor që përfshin Qeverinë e Kosovës; përgatitja e këshillave ligjore, rekomandimeve, vendimeve, udhëzimeve dhe opinioneve brenda fushëveprimit të ministrisë dhe të tjera.

Duke pasur parasysh numrin e madh të seancave karshi numrit të vogël të avokatëve, Istrefi thotë se në ato raste kur avokati i shtetit nuk mund të marrë pjesë në të gjitha seancat, i lejohet që të deklarohet me parashtresë në të cilat i shpreh të gjitha pretendimet e veta. "Ne duke u gjendur para kësaj situatë ligjore, i kemi parë lëndët që janë me prioritet varësisht nga shumica financiare dhe varësisht nga specifikat dhe në të njëjtën kohë, duke u munduar që të mos humbet një seancë për mospjesëmarrje, mirëpo nuk kanë munguar veprimet procedurale që avokati i shtetit i ka ndërmarrë për t'u



deklaruar me parashtresë", ka thënë ai.

Por, rritja e numrit të avokatëve të shtetit po shihet si e domosdoshme nga Ehat Miftaraj pasi, sipas tij, vetëm kjo mundëson mbrojtjen e duhur të shtetit dhe të buxhetit. "Në radhë të parë është interes i Republikës së Kosovës, që Avokatura Shtetërore të ketë resurse të mjaftueshme për t'u dalë ballë numrit të madh të kërkesave që vijnë nga institucionet", ka thënë Miftaraj, duke shtuar se duhet rritur edhe kapacitetet profesionale krahas asaj numerike.

Kur pritet të shtohet numri i avokatëve shtetërorë?

Numri i avokatëve të shtetit në vitin 2019 ishte rritur në nëntë nga pesë sa ishin më parë.

Ky numër sërish nuk po konsiderohet i mjaftueshëm për përfaqësimin e mijëra lëndëve në gjykatë dhe kështu, sipas Istrefit, këtë vit presin t'i rekrutojnë edhe pesë avokatë të tjerë. "Jemi marrë vesh me ministrin e Drejtësisë, (Albulena) Haxhiu, që gjatë këtij viti t'i nisim procedurat për shpalljen e rekrutimit edhe të pesë avokatëve të tjerë si dhe stafit tjetër mbështetës dhe më pastaj të

zgjerohen kapacitetet", ka thënë ai. Planet për rritjen e numrit të avokatëve i ka konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë" edhe këshilltari i ministres së Drejtësisë, Genc Nimoni. "Në kuadër të reformave të brendshme ne kemi paraparë që Avokaturës Shtetërore t'ia rrisim numrin e avokatëve shtetërorë, duke pasur parasysh volumin e punëve që ka Avokatura Shtetërore dhe, gjithashtu, nevojën për rritje qoftë të kapaciteteve njerëzore dhe profesionale", ka thënë ai.

Kjo rritje sërish nuk pritet të ofrojë zgjidhje të menjëhershme për problemet që i ka ky institucion. Sami Istrefi ka thënë se këtij ekipi duhet t'i ofrohet edhe pagë e dinjitetshme dhe trajnime. "Me këtë numër që tani kemi, edhe me staf mbështetës dhe me bashkëpunëtorë profesionalë edhe me avokatë, pa trajnime, pa mbështetje, pa një pagë e cila mund të jetë e dinjitetshme, është e pamundur të kryhet funksioni i avokatit të shtetit", ka thënë Istrefi. Sipas të dhënave, momentalisht nëpër gjykatat po trajtohen edhe lëndë të vitit 2006, ndërsa me trendin e trajtimit të rasteve në gjykatat, rasteve të reja do t'u duhen mesatarisht edhe katër ose pesë vjet për ta nisur shqyrtimin.

Dy të vdekur dhe tetë raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 8 KORRIK (ER) - Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit kanë ndërruar jetë dy persona dhe janë paraqitur tetë raste të reja me Covid-19. Po ashtu, MSh-ja ka

njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë vaksinuar kundër Covidit mbi 5 200 qytetarë. “Në 24 orët e fundit janë dhënë 5 271 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha

qytetet e Kosovës janë dhënë 243 428 doza të vaksinës. Deri më sot 60 759 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Nga 1 721 testime, 8 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24

orëve të fundit është shënuar 2 raste të vdekjes. Sot janë shëruar 7 qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 105 412. Në total numri i rasteve aktive është 151”, ka njoftuar MSh-ja.



Ministri Vitia: Vala e re e pandemisë në vjeshtë është e pashmangshme



Prishtinë, 8 korrik (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka ftuar qytetarët që të vaksinohen kundër koronavirusit pasi, siç ka thënë ai, ekspertët vlerësojnë se në vjeshtë pritet të ketë valë të re të pandemisë Covid-19. Këto komente ai i ka bërë nga salla “1 Tetori” në Prishtinë, pasi ka marrë dozën e parë të vaksinës “AstraZeneca”. “Vjeshta duhet të na gjejë me sa më shumë qytetarë të vaksinuar. Është e vetnja mënyrë dhe me siguri se edhe nëse paraqitet një valë e re

deri në vjeshtë, e që sipas ekspertëve është pothuajse e pashmangshme, vetëm të vaksinuar ruajmë shëndetin e njëri-tjetrit, shëndetin ekonomik, social, ruajmë mirëqenien tonë”, ka thënë Vitia.

Vitia ka folur edhe për hezitimin e qytetarëve që të marrin vaksinën “AstraZeneca”, por ka theksuar se vaksinat që përdorë Kosova janë të miratuara nga Agjencia Evropiane e Barnave (EMA) dhe Administrata Amerikane për Ushqim dhe Barna

(FDA). Ai ka thënë se ky hezitim po vjen pasi individë të papërgjegjshëm me ose pa vetëdije po shkaktojnë dëme në shëndetin publik.

Më tutje, ministri Vitia ka folur edhe për vaksinimin në komunat me shumicë serbe. “Disa nga komunat në pjesën veriore vetëm kanë shkuar ekipet tona dhe kanë treguar që një pjesë e madhe e tyre tashmë janë vaksinuar dhe nuk kanë pasur nevojë për vakcina, kurse në disa komuna të tjera kanë

kërkuar që stafi i tyre, ekipet e vaksinimit, të vijnë dhe të trajnohen në këtë qendër, që është bërë dhe në bazë të kërkesës së tyre u është dërguar edhe numri i vaksinave për të cilin nuk kam shifër të saktë”, ka thënë Vitia.

Vitia ka theksuar se të gjithë qytetarët që duan të vaksinohen do të vaksinohen, teksa ka shtuar se komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian do të ndihmohen nga ekipet mobile që të regjistrohen dhe vaksinohen.

Kosova, sipas Vitisë, deri më tani ka mbi 2 milionë vakcina dhe ka vakcina të mjaftueshme në stoqe. Ai, po ashtu, ka paralajmëruar se gjatë kësaj jave do të bëhet edhe rishikimi i masave kundër Covid-19.

Kosova ka nisur vaksinimin kundër koronavirusit në fund të marsit, ndërsa më 15 qershor ka filluar vaksinimi masiv. Deri më 7 korrik në Kosovë janë vaksinuar mbi 236 mijë qytetarë, ku rreth 58 mijë prej tyre janë vaksinuar plotësisht.

Konjufca i premtion bashkëpunim kryetares së Gjykatës Kushtetuese

PRISHTINË, 8 KORRIK (ER) - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të enjten në takim kryetaren e Gjykatës Kushtetuese, Gresa Caka - Nimani. Në këtë takim është biseduar, ndër të

tjera, për punën e deritashme dhe sfidat e Gjykatës Kushtetuese, si dhe rëndësinë e bashkëpunimit institucional në konsolidimin e kapaciteteve të saj profesionale. Konjufca e ka përgëzuar Caka -

Nimanin për zgjedhjen e saj në krye të Gjykatës Kushtetuese dhe ka premtuar bashkëpunim të ngushtë, duke theksuar se sundimi i ligjit mbetet prioritet i institucioneve të vendit.



KDI-ja: “Bordet politike”, konstantja e secilës Qeveri të Kosovës

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka vlerësuar se “bordet politike” kanë qenë konstantja e secilës Qeveri të Kosovës. Në hulumtimin “bordet politike”, të publikuar të enjten, KDI-ja ka bërë me dije se gjetjet e raportit tregojnë për shkelje të Ligjit për Ndërmarrje Publike nga të gjitha Qeveritë e Kosovës, në kurriz të pavarësisë “politike” të bordeve

“Epoka e re”

PRISHTINË, 8 KORRIK - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka publikuar hulumtimin “Bordet politike” kum ndër të tjera, ka analizuar bordet të cilat udhëhoqën ndërmarrjet publike qendrore gjatë vitit 2020. Gjetjet e raportit të KDI-së tregojnë se e përbashkëta e të gjitha qeverive ka qenë politizimi i bordeve të ndërmarrjeve publike. Sipas KDI-së, kjo ka qenë në kundërshtim me ligjin për këto ndërmarrje. “Gjetjet e raportit tregojnë për shkelje të Ligjit për Ndërmarrje Publike nga të gjitha Qeveritë e Kosovës në kurriz të pavarësisë ‘politike’ të bordeve përkundër obligimeve ligjore që kërkojnë që

anëtarët e bordeve të përzgjedhen ose emërohen në bazë të kriterit të profesionalizimit, integritetit dhe pavarësisë politike. Praktika tregon shumë raste kur kandidatë të subjekteve politike për deputetë të Kuvendit të Kosovës ose kryetarë komunash që nuk kanë arritur të marrin vota të mjaftueshme për t’u zgjedhur në zgjedhjet e viteve të fundit janë përzgjedhur si drejtorë të bordeve të ndërmarrjeve publike”, është thënë në raportin e KDI-së. Raporti flet edhe për mosrespektimin e kuotës gjinore nëpër këto borde. “Analiza tregon edhe për shkelje të tjera që lidhen me përbërjen gjinore të bordeve. Shumica e bordeve dominohen nga burrat, edhe pse ligji kërkon



përfaqësim në masën 50/50. Në praktikë, në vetëm katër nga shtatë bordet e ndërmarrjeve publike qendrore (Trepça, Posta e Kosovës, Infrakos, Ibër-Lepenci, Trainkos dhe kompania për menaxhimin e mbeturinave) ka përfaqësim të grave. Edhe sa i përket deklarimit të pasurisë nga anëtarët e bordeve, gjatë vitit 2020

anëtarët e dy prej shtatë bordeve fare nuk kanë deklaruar pasurinë e tyre”, është thënë në raport. Ky institut ka kërkuar nga institucionet e Kosovës që t’i respektojnë kriteret profesionale gjatë procesit të emërimit të anëtareve të bordeve. “KDI kërkon nga Qeveria e Kosovës që gjatë procesit të zgjedhjes apo

emërimit të anëtareve të bordeve të ndërmarrjeve publike, të vendosë në bazë të kriterit të profesionalizimit, integritetit dhe pavarësisë politike, duke qenë se ndërmarrjet publike, përmes shërbimeve të tyre, prekin drejtpërdrejt jetën e qytetarëve dhe interesin e gjerë shoqëror”, është thënë në raportin e KDI-së.

Kuvendi shkarkon bordin e RTK-së, ky i fundit e quan vendim politik dhe antiligjor

PRISHTINË, 8 KORRIK (ER) - Deputetët e Kuvendit të Kosovës, konkretisht të shumicës parlamentare, kanë votuar të enjten pro shkarkimit të bordit të Radiotelevizionit të Kosovës (RTK). Anëtarët e bordit Sali Bashota, Agron Gashi, Lirim Geci, Fadil Miftari, Ilir Bytyçi, Bajram Mjeku, Petrit Musolli dhe Albinot Maloku janë shkarkuar me 64 vota për, asnjë kundër dhe një abstenim. Kryetarja e Komisionit për Media në Kuvendin e Kosovës, Doarsa Kica – Xhelili, para deputetëve ka paraqitur arsyetimin për shkarkimin e këtij bordi. “Anëtarët e bordit drejtues kanë dështuar të ofrojnë qasje të papenguar auditorit të përgjithshëm. Asnjë nuk kishte ndonjë dispozitë që kontestonte auditimin. Bordi ka dështuar të luajë rolin vendimmarrës dhe mbikëqyrës”, ka thënë ajo, duke shtuar se bordi nuk ka propozuar strategji për financim. “Kjo tendencë për shpenzime dhe rritje e pakontrolluar e punësimeve ka shkaktuar gjendje të rëndë dhe borxhe”, ka thënë ajo. Ndërsa partitë opozitare e kanë kundërshtuar rekomandimin e Komisionit për Media për shkarkimin e bordit të RTK-së. Deputeti i PDK-së, Bedri Hamza, ka thënë se në këtë mënyrë LV-ja po dëshiron ta plasë shtetin.

“Nuk e mbroj mungesën e punës të asnjë bordi, por kjo nuk është kapje e shtetit, është plasje e shtetit, me një vendim shkarkoni të gjithë bordet e Kosovës”, ka thënë Hamza. Kurse deputeti LDK-së, Agim Veliu, ka thënë se një veprim i tillë është kundër fjalës së lirë. “Personalisht distancohem nga kjo ndërhyrje. Nuk do të jemi pjesë e kësaj goditje ndaj fjalës së lirë dhe demokracisë. Ju që keni vendosur ta kapni edhe këtë institucion, dërgoni një komisar politik për propagandë. Ndaloni dënimet kolektive dhe respektoni institucionet e pavarur”, ka thënë Veliu. Në anën tjetër, shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se RTK-ja nuk duhet të trajtohet në këtë formë. “Sot kemi vënë në rendin e ditës një pikë e cila rekomandon shkarkimin e bordit të RTK-së, që në rrethana normale as ishte dashur të trajtohet në këtë formë e, mbi të gjitha, në aspektin e trajtimit të institucioneve publike si është RTK-ja, duhet të trajtohet në mënyrë krejt tjetër. Është më se e vërtetë që raporti që ka ardhur nga RTK-ja nuk ka qenë raport i mirë”, ka deklaruar Tahiri. Në fillim të seancës, Kuvendi nuk ka aprovuar raportin vjetor të RTK-së për vitin 2020. Ndaj këtij vendimi ka reaguar Bordi i Radiotelevizionit të Kosovës



(RTK). Bordi i shkarkuar i RTK-së e ka quajtur politik dhe antiligjor vendimin e shumicës parlamentare në Kuvend. Bordi në fjalë ka paralajmëruar se do t’i ndjekë të gjitha rrugët ligjore për ta kundërshtuar këtë vendim. “Veprimi i sotëm i shumicës parlamentare në Kuvendin e Kosovës për shkarkimin e Bordit të RTK-së është politik, antiligjor dhe paraqet ndërhyrje flagrante

në punën e transmetuesit publik. Ky vendim është goditje e rëndë ndaj vlerave demokratike dhe lirisë së mediave. Arsyetimi i shumicës parlamentare për shkarkimin e bordit të RTK-së nuk ka asnjë argument faktik, përpos motivit të qartë politik. Bordi aktual ka qenë një ndër bordet më profesionale, i përbërë nga emra të njohur të fushës akademike dhe të mediave. Bordi

i RTK-së do t’i ndjekë të gjitha rrugët ligjore për ta kundërshtuar këtë vendim arbitrar. Bordi i RTK-së u bën thirrje organizatave vendore dhe ndërkombëtare të cilat merren me mbrojtjen e lirisë së mediave që të reagojnë ndaj këtij vendimi politik dhe arbitrar të shumicës parlamentare në Kuvendin e Kosovës”, është thënë në reagimin e bordit të shkarkuar të RTK-së.

Komuna e Rahovecit mban disa dëgjime publik për buxhetin e vitit 2022

Rahovec, 8 korrik - Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) të kryesuar nga Afrim Dina kanë vazhduar mbajtjen e dëgjimeve publike për buxhetin e vitit 2022 dhe Kornizën Afatmesme të

Buxhetit (KAB) për vitet 2022-2024 me banorë të fshatrave Çifllak, Polluzhë, Dobidol, Kramovik, Guri i Kuq dhe Mrasor. Kryesuesi i KPF-së, Afrim Dina, ka thënë që së bashku me anëtarët e tjerë të

këtij komiteti janë duke marrë pjesë në dëgjimet publike për të marrë kërkesat e qytetarëve. Ai ka treguar se buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2022 për investime kapitale është 4 milionë e 922 mijë e 147 euro.



Përfundon rregullimi i fushës së sportit në Roganë të Kamenicës

Kamenicë, 8 korrik (ER) - Komuna e Kamenicës, sipas një marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën Humanitare "Sejdi Kryeziu", kanë bashkëfinancuar projektin për rregullimin e fushës së sportit në Roganë. Ky projekt, i cili kap vlerën afër 10 mijë euro, tashmë është finalizuar, me ç'rast ditën e shtunë pritet të fillojë edhe Turniri Tradicional "Rogana 2021".

Kryetari i komunës, Qëndron Kastrati, ka deklaruar se është i lumtur që ky projekt është realizuar. "Turniri tradicional 'Rogana' garat do t'i nisë në fushën e sportit të rregulluar në bashkëpunim me shoqatën humanitare 'Sejdi Kryeziu' dhe e mbështetur nga biznese dhe vullnetarë nga komuniteti. I

lumtur që arritëm të ndajmë rreth 10 mijë euro për rregullimin dhe mbështetjen e këtij turniri", ka deklaruar Kastrati.

Mes të tjerash, Kastrati ka falënderuar të gjithë ata që ndihmuan realizimin e këtij projekti, duke u uruar suksese ekipeve që do të marrin pjesë në turnir. "Falënderoj drejtorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Arianit Ibrahim, dhe menaxherin e këtij projekti, Leotrim Spahiu, për punën dhe përkujdesjen. Ekipeve që do të marrin pjesë u uroj shumë suksese, ndërkaq sportdashësve çaste të këndshme nga tribunat në mbështetje të ekipeve favorite", ka shtuar ai.

I lumtur për përfundimin e këtij projekti u shpreh edhe drejtori i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe



Sportit, Arianit Ibrahim, dhe u uroi të gjitha ekipeve pjesëmarrëse suksese në gara.

Gjithashtu, vlen të theksohet se ky turnir dhe rregullimi i fushës së sportit në Roganë është

përkrahur dhe ndihmuar nga shumë qytetarë dhe biznese të ndryshme.

Në lagjen "2 Korriku" vendosen dy stacione pritëse të autobusëve

Mitrovicë, 8 korrik (ER) - Në kuadër të projektit "Mbështetja e iniciativave për siguri në komunitet përmes Këshillave Lokale për Siguri në Bashkësi (KLSB)" janë inauguruar në Mitrovicë tri projekte, të mbështetura nga misioni i OSBE-së me fondet e Ambasadës së Norvegjisë në Kosovë.

Nga iniciativa e KLSB-së "2 Korriku" nga komuniteti ashkali në Mitrovicë janë vendosur dy stacione pritëse të autobusëve sipas modelit ekzistues të stacioneve në qytet. Tani qytetarët kanë siguri publike më të madhe dhe pritja e udhëtarëve për autobus është më e sigurt dhe më e lehtë.

Nënkryetari i Mitrovicës, Faruk



Mujka, ka falënderuar për kontributin e dhënë për vendosjen e dy stacioneve pritëse të autobusëve në

Mitrovicë, njërën te kisha ortodokse e tjetra përballë rrugës "2 Korriku" në Mitrovicë. Pjesë e këtij aktiviteti ishin edhe

drejtori i Departamentit, Edward Anderson, si dhe shefi i sektorit, Zoran Mitrevski nga misioni i OSBE-së.

Përfaqësuesit e OSBE-së e kanë çmuar bashkëpunimin me komunën e Mitrovicës, Policinë e Kosovës, KLSP-në, "2 Korriku"-n dhe me organet e tjera të sigurisë.

Në po të njëjtën ditë janë inauguruar edhe dy projekte të tjera në fshatin Çabër me rastin e renovimit të sallës sportive si dhe në Vushtrri për "3D zebra" afër shkollës "Musa Venhari".

Misioni i OSBE-së me Ambasadën e Norvegjisë janë duke përkrahur KLSB-të e ndryshme në mbarë Kosovën që nga viti 2013. Vetëm në dy vjetët e fundit janë përkrahur mbi 30 projekte/iniciativa me qëllim të mbështetjes së KLSB-ve në zbatimin e iniciativave të sigurisë në komunitet.

Inspektorët në kryeqytet zbatojnë vendimin për një objekt në "Dardani"

PRISHTINË, 8 KORRIK (ER) - Inspektorët e ndërtimit në Komunën e Prishtinës, bashkë me Policinë e Kosovës, kanë ndërmarrë të enjten një aksion në lagjen "Dardania" për shkak të dëmtimeve që i janë shkaktuar një objekti kolektiv. Në rastin në fjalë, pala, pas renovimeve të brendshme në objekt

banesor, i ka dëmtuar dhe rrënuar muret e përdhësës së objektit kolektiv. "Inspektori i zonës ka ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore me kohë, si ndërprerjen e punimeve, shqiptimin e gjobës dhe vendimin që obligon palën për ta rikthyer objektin në gjendjen e mëparshme. Meqë pala nuk ka përfillur vendimet

e urdhëresat e inspektorit dhe ka vazhduar punimet, ndaj tij është iniciuar edhe kallëzim penal", ka njoftuar komuna e Prishtinës.

Kompania e kontraktuar nga komuna e Prishtinës do ta bëjë muratimin e asaj pjese, kurse shpenzimet do t'i barten palës e cila i ka dëmtuar muret e objektit.



Besnik Beqiri zgjedhet president i bordit të OEGJK-së

PRISHTINË, 8 KORRIK (ER) - Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK) ka mbajtur kuvendin e dhjetë zgjedhor në të cilin janë zgjedhur anëtarët e rinj të bordit të kësaj ode. President me mandat dyvjeçar është zgjedhur Besnik Beqiri, i cili është pronar i kopanisë "Kerasan". Përveç presidentit, kuvendi ka zgjedhur edhe anëtarët e bordit të OEGJK-së. Anëtarë të bordit janë zgjedhur: Eriola Bibolli nga "ProCredit Bank", e cila do të jetë edhe zëvendëspresidente e bordit të OEGJK-së, Ylli Dushi nga "ND-Pay", i cili do të jetë përgjegjës për thesarin, Fadil Hoxha nga "Jaha Group", Shqipe Dushi nga "DHL"-ja, Rene Eschemann nga Banka Gjermane për Zhvillim (KfW) dhe Visar Dobrosi nga "Recura".

Me këtë rast, presidenti Besnik Beqiri, pasi ka përshëndetur punën e bordit të vjetër dhe ka falënderuar Ambasadën e Gjermanisë në Kosovës për mbështetjen e pandashme që i

jep OEGJK-së, ka shprehur rëndësinë e vazhdimësisë në punën e kësaj ode. Ai ka theksuar se është privilegj marrja e përfitimeve nga Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare, duke nisur nga kontaktet e ndërhuara me anëtarët vendorë si dhe ata gjermanë e duke vazhduar me shërbime të tjera.

Në pjesën e parë të kuvendit, drejtoresha e OEGJK-së, Nora Hasani, ka prezantuar rezultatet e punës së kësaj ode gjatë vitit 2020. Hasani ka thënë se OEGJK-ja përgjatë vitit 2020 ka përkrahur anëtarët në eksport për t'iu ndihmuar që të kyçen në boshllëqet e krijuara në zinxhirët e furnizimit të kompanive gjermane, shkaku i pandemisë. Gjithashtu, përkundër masave kufizuese për shkak të pandemisë, OEGJK-ja në mënyrë të vazhdueshme ka zhvilluar aktivitete, shumica prej tyre në formën "online", me të vetmin qëllim që t'u ndihmojë kompanive anëtare në përgjigje të



kërkesave të tyre. Përpos përkrahjes së kompanive anëtare, OEGJK-ja gjatë vitit 2020 bashkë me Konrad-Adenauer-Stiftung ka botuar manualin për investitorë të huaj dhe guidën "Kosovo, Facts and Figures". Gjithashtu, në punimet e kuvendit është paraqitur, diskutuar dhe aprovuar plani i punës për vitin 2021, buxheti,

ndryshimet statutores dhe raporti i auditimit për vitet 2019 dhe 2020. Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK) është organizatë që fokusin kryesor e ka tek anëtarët dhe është e përkushtuar për t'i fuqizuar më shumë lidhjet bilaterale të tregtisë dhe të investimeve në mes të Kosovës dhe Gjermanisë. OEGJK është themeluar me iniciativë të

Ambasadës së Gjermanisë në Prishtinë dhe aktualisht përfaqëson 130 kompani anëtare, të cilat në total punësojnë mbi 15 mijë punëtorë. Kjo odë ofron këshilla, përkrah dhe përfaqëson kompanitë gjermane në Kosovë që kërkojnë të investojnë, zhvillohen ose ta zgjerojnë aktivitetin e tyre biznesor. Gjithashtu, OEGJK-ja përkrah dhe këshillon kompanitë e Kosovës të cilat tregtojnë me Gjermaninë përmes një game të gjerë të shërbimeve duke iu krijuar mundësi për rrjetëzim dhe të bërit biznes.

Meqenëse OEGJK-ja është në zemër të komunitetit të biznesit gjerman në Kosovë, si organizatë luan rol aktiv në përmirësimin e mjedisit të të bërit biznes për kompanitë anëtare, duke siguruar një zë të respektuar për anëtarët e kësaj ode. Anëtarësia në OEGJK është e mundur për kompanitë dhe institucionet që kanë lidhje tregtie apo investimi me Gjermaninë.

Fillon fushata e korrje-shirjeve në Malishevë



MALISHEVË, 8 KORRIK (ER) - Zyrtari i lartë i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural i komunës së Malishevës, Milaim Morina, ka bërë me dije të enjten se ka filluar zyrtarisht fushata e korrje-shirjeve në këtë komunë. "Është formuar shtabi komunal për korrje-shirje dhe janë bërë të gjitha përgatitjet për një mbarëvajtje sa më të suksesshme dhe besojmë në përfundim brenda afatit kohor të korrje-shirjeve në komunën tonë", ka deklaruar Morina. Ai ka thënë se shtabi komunal

për korrje-shirje ka përgatitur planin operativ që të punojë sipas rregullores për korrje-shirje. "Aty parashihet edhe çmimi për hektar të cilin e ka rekomanduar MBPZHR-ja prej 90 eurosh. Drejtoria në fjalë ka kërkuar nga kryesitë e fshatrave që të formohen shtabet lokale si dhe të bëhet grumbullimi i të dhënave gjatë fushatës së korrje-shirjeve. Duke pasur parasysh sipërfaqet e mbjella me drithëra, rreth 3 590 hektarë, në territorin e Komunës së Malishevës këtë vit mund të angazhohen 40

autokombajna, ndërsa kjo komunë ka në dispozicion 26 autokombajna, prandaj duhet siguruar edhe 14 sosh", ka thënë ai.

Komuna e Malishevës ka bërë me dije se rendimentet e grurit sillen nga 4 500 deri në 5 500 kilogramë për hektarë. "Nëse mbretëron koha me mot të mirë, fushata e korrje-shirjeve në komunën e Malishevës pritet të përfundojë brenda afatit prej dy javësh, i paraparë sipas shtabit komunal për korrje-shirje", ka njoftuar kjo komunë.

KRU 'Prishtina' zbulon dhjetëra kyçje ilegale dhe ndërhyrje në rrjetin e ujësllësit

PRISHTINË, 8 KORRIK (ER) - Kompania e Ujësllësit Rajonal KRU "Prishtina" ka njoftuar se inspektorët e saj kanë zbuluar disa kyçje ilegale, manipulime me valvola dhe ndërhyrje të tjera në rrjet.

Kjo kompani ka bërë me dije se është duke vazhduar inspektimi në terren për zbulimin e rasteve që kanë të bëjnë me ndërhyrjet në rrjetin e ujësllësit. "Dhjetëra

kyçje ilegale në sistemin e rrjetit të ujësllësit po zbulohen nga inspektorët dhe kontrollorët tanë çdo ditë dhe të gjitha rastet janë duke u procesuar më tutje. Ata janë vazhdimisht në terren nga ora 06:00-22:00. Investimet dhe intervenimet në rrjetin e ujësllësit, në të gjitha zonat e shërbimit, po vazhdojnë", ka njoftuar KRU "Prishtina". Kjo kompani ka bërë thirrje për

shpenzimin racional të ujit. "Shpenzimi racional i ujit të pijshëm më se i domosdoshëm. Implimentet e trajtimit të ujit, Shkabaj, Albanik e Badoc, po funksionojnë me kapacitete maksimale. Për një furnizim stabil me ujë dhe infrastrukturë funksionale, shpenzo racionalisht ujin, mos realizo kyçje ilegale dhe paguaj faturat e ujit rregullisht", ka njoftuar KRU "Prishtina".




Fahrie Morina zgjedhet drejtoreshë e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit

Prishtinë, 8 korrik (ER) - Kuvendi i Kosovës ka zgjedhur Fahrie Morinën kryetare e Autoritetit Rregullator për

Shërbimet e Ujit. Ajo ka marrë shumicën e votave nga deputetët e pranishëm në seancë. Mandati i saj do të jetë

pesëvjeçar. "Fahrie Morina zgjedhet kryetare e Autoritetit Rregullator të Ujit me mandate pesëvjeçar", ka thënë

nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci. Pas kësaj, Bogujevci ka mbyllur punimet e seancës plenare.




RRËFIME NGA ISH-I BURGOSURI POLITIK DHE I MBIJETUARI I MASAKRËS
NË BURGUN E DUBRAVËS, NAIT HASANI

Nga kush e morëm lajmin për lirimimin nga burgu i Nishit në mars të vitit 2002

Zilet paralajmëruese për të rënë në gjumë na trazuan mendimet

Nata ra e trazuar. Ajo ua davariti gjykimet e arsyeshme të burgosurve duke i lënë hapësirë imagjinatës së tyre pas fikjes së dritave për të rënë në gjumë. Ato shqetësime të tyre i vëreje nga lëvizjet e tyre në shtrat. Kishte heshtje, pak fjalë dhe shpresë. Zilet për zgjim dhe për fjetje çdo ditë na kujtonin se kaloi edhe një ditë tjetër në burg. Në burg, gjatë dimrit, dita është e shkurtër, ndërsa nata e gjatë. Pasi binim të flinim, ashtu i shtrirë në shtrat, kujtoja dënimin që na kishte dhënë Serbia në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, me 20 vjet burgim. Ky gjykim kishte ndodhur më 16 dhjetor 1997. Dënimet shprehnin ashpërsinë e pushtetit serb kundër shqiptarëve, por as kjo ashpërsi nuk mund të jepte efekt, as dënimet e shokëve më herët që vetëm na ngritën më shumë dhe na bënë më të vendosur në luftën tonë për liri. Lëvizja jonë thoshte: "Një bie, një mijë ngrihen". Dënimet tona kishin ngritur në këmbë një popull të tërë me UÇK-në në ballë, në luftë për liri dhe çlirim nga Serbia. Kaloi edhe një ditë tjetër në burg dhe dhjetori po afrohej. Pritej të na vinin vizita para ndërrimit të motit të vitit 2001. Disa familje ishin më të qeta pas lirimimit të një numri goxha të madh të të burgosurve. Disa të burgosur e kishin blerë lirinë me marka nga avokatët dhe gjyqtarët. Kishte raste që as paraja nuk vlente për lirimimin e disa të burgosurve, sepse në qarqet shtetërore filhet për përfitime më të mëdha për

lirimimin e tyre. Kur erdhën familjarët në vizitë, treguan se sa janë duke u përpjekur të gjithë për lirimimin e të burgosurve të fundit nga burgjet serbe. Nuk kishim mbetur shumë të burgosur, por ishim të dënuar dhe të nxënë në vijat e frontit në luftimet në mes të UÇK-së dhe policisë dhe ushtrisë serbe. Kishin mbetur në burg të gjithë ata që ishin pjesë e fronteve. Për të bërë këmbim në mes të të burgosurve nuk kishte asnjë mundësi pasi që në Kosovë nuk kishte serb të burgosur. Kështu që prisnim trysninë ndërkombëtare. Dhe kishim shpresë, pas vizitës që bënim familjarët, që vitin e ri do ta presim në Kosovë. Por, kjo shpresë nuk u bë realitet atë vit, sepse ende nuk ishin arritur pazaret e mjaftueshme në negociata për lirimimin tonë! Vizitat për Viti të Ri ishin pak më të gjata se një orë dhe me më shumë ushqime për të burgosurit. Më 31 dhjetor 2001, në burgun e Nishit, në sallën e korridorit kishim një televizor dhe ulëset e drurit dhe disa tavolina që të bënim një përgatitje për Vitin e Ri. Televizionin na lanë gjatë ndezur deri pas orës 12:00 të natës. Me lëngjet që kishim blerë në kantinë dhe ato të dërguara nga shtëpia, filloi festa e Vitit të Ri në burgun e Nishit. Dikush kishte futur edhe alkool në burg përmes tetrapakëve dhe konservave. Për mua me rëndësi ishte që të burgosurit në këto rrethana të ndihen mirë,



sidomos në këto çaste festive. TV-ja jepte programe në serbisht. Tregonte të arriturat e Serbisë. Tregonte edhe humbjet dhe dhunën që përdorej nëpër qytete të Serbisë dhe në kryeqytet, Beograd. Në këto humbje përmendej edhe vrasja e Arkanit, e drejtuesit kryesor të "Tigrave" që kishte bërë krime në Bosnjë, Kroaci dhe Kosovë. Ushtarët e tij ishin të njohur për krimet dhe vrasjet makabre në këto shtete, që kishin vrarë burra, gra dhe pleq. Kjo vrasje ma kujtoi një takim ballë për ballë me të në

burgun e Mitrovicës së Sremit. Ai kishte ardhur në burg për të na vizituar dhe për të na parë kush jemi. Së bashku me drejtorin e burgut, Trifun Ivković, ai erdhi në korridorin e pavijonit numër dy të Sremit. Me urdhër të drejtorit ne dolëm në anën përballë tyre. Ai së bashku me drejtorin na pyeste kush jemi dhe sa jemi të dënuar.

Në rend, përballë Arkanit, ishim unë, Ukshin Hoti, Agim Makolli, Besim Rama, Idriz Asllani, Agim Hulaj dhe Hasan Zeneli. Pas deklarimeve se kush jemi, treguam secili për dënimin tonë. Ai (Arkani) na shikonte me egërsi, sidomos kur i tregonim sa vite burg jemi dënuar. Unë i thashë se jam dënuar sipas nenit 136, lidhur me nenin 47, me 20 vjet burgim, për themelimin e UÇK-së. Më shikoi nga këmbët deri te flokët. Në shkurt të vitit 1999, pas negociatave të Rambujesë në mes të përfaqësuesve, delegacioneve të UÇK-së dhe të shtetit serb, ai sërish na vizitoi. U paraqit edhe Besim Rama, i cili tha se jam i dënuar 20 vjet me grupin e Adem Jasharit, i cili vinte nga Prekazi i Epërm dhe ishte bashkëluftëtar i Adem Jasharit. Pastaj Idriz Asllani, i dënuar 15 vjet burgim, po ashtu me grupin e Adem

Jasharit. Hasan Zeneli, 15 vjet burgim me grupin tonë të UÇK-së. Agim Makolli, i dënuar 19 vjet me grupin tonë të UÇK-së. Agim Hulaj, i dënuar 10 vjet burgim me grupin tonë të UÇK-së nga Deçani dhe Ukshin Hoti, i dënuar pesë vjet burgim si intelektual. Arkani bëri kinse s'na njihje, por ai e dinte shumë mirë kush ishim. Ardhja e tij në burg nuk ishte lajm i mirë. Ishte lajm i sjelljes së vdekjes. Por, ne ishim të vdekur për çdo ditë, kështu që vdekja ishte shpëtim për ne.

Duke parë televizion, duke dëgjuar lajmin për vrasjen e Arkanit, mendja më vajti në Mitrovicë të Sremit, kur Arkani na kishte vizituar në shkurt të vitit 1999. Ai ishte vrarë nga klanet kriminale serbe. Ai kishte marrë dënimin e merituar jo për krimet që kishte bërë në Kosovë, por për krimet në mes të bandave.

Viti i Ri erdhi me shpresa të reja. Të burgosurit uruan njëri-tjetrin për lirim sa më të shpejtë nga burgjet dhe ngrehëm dolli në emër të lirimimit tonë, kurse në qytet dëgjoheshin krismat e fishekjarrëve që lëshonin në ajër qytetarët serbë. 130 vjet më parë, këtu e kishte pritur Vitin e Ri edhe Idriz Seferi, një nga drejtuesit e Lëvizjes për Pavarësi



të Shqipërisë më 1912. Edhe ai ishte liruar nga ky burg edhe pse kishte qenë i dënuar me 101 vjet burgim nga Sulltani. Nishi në atë kohë ishte i tëri me shqiptarë dhe këtu ishte edhe Molla e Kuqe. Tashmë edhe ne ishim në këtë burg.

Më 15 janar 2002 unë e kisha datëlindjen. Shokët e dhomës më uruan ditëlindjen dhe lirimim nga burgu. Datëlindjet i festonim me shokët e dhomave. Datëlindjet tregonin sa të pjekur e sa në moshë ishim. Kishte shokë tanë të burgosur që kishin lëshuar mustaqe dhe i numëronin muajt e vitet në burgje, ndërsa mustaqet nuk i hiqnin. Ata thoshin se që nga ditëlindja s'i kam hequr mustaqet dhe kështu do t'i mbaj derisa të lirohem etj. Me disa prej tyre luanim shah, sidomos kur lodheshim duke lexuar. Loja e shahut me disa kishte kuptim pasi nuk pranonin humbjen dhe hidhëroheshin. Televizioni dhe ndonjë gazetë në serbisht dhe shqip na vinte kohë pas kohe. Për të kaluar kohën sa më shpejt dhe lehtë, argëtoheshim me shah, domino dhe lexonim, besa flisnim në telefon me familjarë dhe shokë nga Kosova.

Në një mbrëmje më merr në telefon Muhamet Mavraj, gazetar dhe botues i gazetës "Epoka e re". Pas bisedës që zhvilluam bashkë, më thotë se këto ditë do të liroheni nga burgju të gjithë. Me Muhametin biseduam për daljen tonë, biseduam që pas daljes nga burgju vizitën e parë duhej bërë në Prekaz te varri i Adem Jasharit, pastaj në TMK, tek ish-ushtarët e UÇK-së, nëpër shokë dhe bashkëlloftëtarë, nëpër familjet që kanë dhënë të dashurit e tyre për lirinë e Kosovës.

Si çdo ditë tjetër, edhe 26 marsi ishte i njëjtë në atë mëngjes. Rreth mesditës hynë gardianët në korridor dhe u dha urdhri që të gjithë t'i përgatitim teshat dhe të dalim një nga një në korridor.



Disa të burgosur mendonin se po na dërgojnë në një burg tjetër diku në Serbi, disa të tjerë ashtu e disa të tjerë kështu. Unë e dija se burgju kishte marrë fund, prandaj u thashë shokëve se burgut i erdhi fundi. Teksa bëheshim gati, gardianët dolën jashtë të na pritnin. Dikush, në këtë kohë, sa ata ishin jashtë, kishte telefonuar në Prishtinë dhe kishte marrë lajmin se autobusët e UNMIK-ut janë nisur për të na marrë nga burgjet. Ky lajm u përhap shpejt te të gjithë të burgosurit. Ky lajm tregonte përfundimin e vuajtjeve të bashkëvuajtësve të mi nëpër burgjet e Serbisë. Ky lajm tregonte se më nuk do të ketë të burgosur politikë shqiptarë në burgjet e Serbisë. Të gjitha burgimet për njëqind vjet përfundonin sot për shqiptarët në burgjet serbe. Sa vrasjet, sa vuajtjet, sa tortura ishin bërë nëpër këto burgje kundër shqiptarëve për t'i mbajtur të

nënshtruar. Kishte ndodhur që këto burgje nuk i nxinin shqiptarët sepse kishte shumë të burgosur. Por, sot vuajtjet tona morën fund. I mblodhëm rrobat dhe dolëm. Të gjithëve na kontrolluan një nga një trupin dhe pakot me rroba. Gardianët disa të burgosurve u zunë telefonat që i kishin fshehur në tesha dhe ua morën. Pas këtij kontrolli të rreptë, vetëm pritnim transferimin tonë. Derisa prisnim me shokë bisedonim për këtë rrugëtim të fundit. Thoshim se do të na lirojnë në Merdar ose në Prishtinë. Sa gëzim që shprehnin fytyrat tona. Ishin plot hare. Së bashku me Isakun, Naimin dhe Vebun dhe me bashkëvendësin tim Hasan Hasanin, babë dëshmori, të cilit i ishte vrarë djali, Masari, me uniformë të UÇK-së, rrinim qetë. Ata që kishin folur në telefon me Prishtinë, treguan se në Merdar kanë dalë të na presin familjarët dhe shumë qytetarë. Pas disa

orëve kontroll, morëm urdhër të ecnim drejt autobusëve që na pritnin. Aty i pritnim edhe autobusët nga Mitrovica e Sremit që kishin shkuar për t'i marrë të burgosurit shqiptarë. Pasi mbërritën ata, na hipën në autobusë.

Moti në Nish ishte vranët. Gardianët na thanë të mbajmë kokën ulur, mos të shikojmë rrugës, por askush nuk e mbante kokën ulur. Secili kërkonte të shikonte daljen nga ky ferr. Dalja nga ky ferr ishte shpëtim për ne. Ishte ikje nga purgatori i rrahëve të Dantës. Të zitë e ullirit e kishim kaluar dhe sot ishim duke u kthyer për atdhe, për Kosovën tonë që na mungonte shumë, të cilën e kishim lënë të okupuar, por tani do ta gjenim të çliruar falë sakrificës së ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe miqve tanë ndërkombëtarë të mbështetur nga NATO. U mbyllën dyert e autobusëve, lëvizën rrotat e tyre që dukej se po

tërhiqni zvarrë një shekull jetë dhe na dukej se toka po ndahej në dysh.

Dolëm në rrugën drejt Kosovës, lamë mbrapa burgun dhe kujtimet për dhunën e përdorur ndaj nesh. E mbyllëm atë dritare historike dhe hapëm një dritare të re të jetës sonë në Kosovë.

Autobusët udhëtonin, ne mendonim dhe ndienim mall të madh për atdheun, për familjen dhe për shokët. E kaluam Prokoplën diqysh ngadalë. Lexonim në tabela emra shqip të fshatrave. Sapo nata po binte, hymë në Kurshumli. Radioja filloi transmetimin e muzikës shqip. Këndonte Shaqir Cërvadiku një këngë që nuk e kisha dëgjuar kohë të gjatë. Më ngjalli mall kënga e tij. Më dha emocion. Asnjëherë më i bukur se sot nuk më dukej zëri i tij. Sapo u errësua mbërritëm në Merdar. Autobusët u ndalën, jashtë tij dolën gardianët serbë. Mbetëm brenda ne e hynë brenda gardianët shqiptarë autobusë. E kaluam pikën e kontrollit në Merdar. Sa mendoja se autobusët do të ndalën që të përshëndetemi me familjarë dhe shokë dhe me të gjithë ata që kishin dalë të na pritnin, shoferët i dhanë gaz furishëm autobusëve dhe s'i ndalën. Vetëm i pashë njerëzit e shumtë që kishin dalë të na pritnin. Thërritnin emrat tanë. Kishin marrë me vete flamurin kombëtar të cilin e valëvitnin dhe, po ashtu, fotografitë tona. Në veturën e dikujt pashë një fotografi timen prapa grilave. Autobusët kaluan mes turmës të qytetarëve dhe të familjarëve që kishin dalë të na pritnin dhe brohoritnin pa ndal "UÇK, UÇK, UÇK". Donim të ndaleshim aty, të përqafoheshim, të gëzoheshim, të qeshnim dhe të qanim, por planifikimi ishte bërë nga tjetërkush. Shoferët e autobusëve vazhduan udhëtimin ashtu sikurse u kishte kërkuar UNMIK-u, drejt Kosovës, drejt tokës së lirë. (Vijon)





ALI AHMETI LEGJENDË

Gjenerali Legjendar i Shteteve te Bashkuara te Amerikes, Komandanti historik i NATO-s, i mirenjohuri Wesley K. Klark!

Gjunjzuesi i Serbisë dhe kriminelit Milosheviq! Udhëheqësi i popullit shqiptar Ali Ahmeti - Legjendari heroik i

luftës së armatosur çrimitare kundër Serbisë pushtuese! Urdhërdhënësi e bombarduesi i Serbisë gjenocidale, ballë për

ballë e sy me sy, i jep vleresimin më të madh ndërkombëtar të Amerikes!
ALI AHMETI LEGJENDAR!

Ismet SYLEJMANI,
Prishtinë,
8 Korrik 2021



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

11 sportistë do ta përfaqësojnë Kosovën në Lojërat Olimpikë

PRISHTINË, 8 KORRIK - Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) të enjten e ka bërë publike listën e sportistëve që do ta përfaqësojnë Kosovën në Lojërat Olimpikë "Tokio 2020" të cilat fillojnë më 23 korrik dhe zhvillohen deri më 8 gusht. Për dallim prej Lojërave Olimpikë "Rio 2016", ku Kosova përfaqësohej nga tetë sportistë, tani në "Tokio 2020", pjesëmarrës do të jenë 11 sportistë, gjashtë prej tyre femra dhe pesë meshkuj. Të pranishëm në ceremoninë e publikimit të emrave olimpikë ishte kryetari i KOK-ut, Ismet Krasniqi, sekretari i përgjithshëm, Shasivar Haxhijaj dhe një nga sportistët që do ta përfaqësojë Kosovën në "Tokio 2020", boksierja Donjeta Sadiku. "Po e shpallim listën e fundit të garuesve të cilët do të marrin pjesë në 'Tokio 2020'. Gjithsej kemi 11 sportistë të cilët vijnë nga gjashtë sporte të ndryshme: xhudo, mundja, atletika, noti, boksi dhe shenjëtari sportive. Prej 11 sportistëve, gjashtë prej tyre janë femra, ndërsa pesë meshkuj. Kjo do të thotë që ende në Kosovë po dominojnë vajzat dhe po na bëjnë krenarë dhe dua t'i falënderoj. Prej

kësaj liste me normë olimpikë janë Majlinda Kelmendi (xhudo, kategoria -52 kg), Distria Krasniqi (xhudo, -48 kg), Nora Gjakova (xhudo, -57 kg), Lorian Kuka (xhudo, -78 kg), Akil Gjakova (xhudo, -73 kg). Të gjithë këta janë nga xhudo, kurse në mundje kemi Egzon Shalën në kategorinë -125 kg, stil i lirë. Kurse të ftuar nga komisioni trepalësh i kemi Donjeta Sadiku (boks, kategoria 57-60 kg), Drilon Ibrahim (shenjëtari sportive, 10 metra pushkë ajrore). Të ftuar sipas vendeve të rezervuara, për shkak të universalitetit, e kemi Eda Zeqirin (not, disiplina 400 metra stil i lirë), kemi Olt Kondirollin (not, disiplina 100 metra stil i lirë), edhe Musa Hajdari (atletikë, 800 metra vrapim)", ka thënë Ismet Krasniqi, kryetar i KOK-ut. Ndërsa boksierja Donjeta Sadiku ka folur për synimet që ka në Lojërat Olimpikë. "Pjesëmarrja në Lojërat Olimpikë për të gjithë sportistët është një ëndërr, po ashtu edhe për mua. Jam shumë krenarë që e kam bërë realitet këtë ëndërr. Kam besuar gjithmonë se një ditë do t'i arriti këto suksese me



punë të madhe dhe përkushtim të madh. Synimet e mia janë me marrë ndonjë medalje olimpikë dhe vazhdimi deri te e arta", ka thënë Sadiku. Ndërsa sekretari i përgjithshëm i Komitetit Olimpik të Kosovës, Shasivar Haxhijaj (KOK), tregoi se të gjithë sportistët që do ta përfaqësojnë Kosovën në "Tokio 2020", e kanë kryer procesin e vaksinimit, duke e

marrë edhe dozën e dytë të vaksinës kundër Covid-19. "Krahas këtyre përgatitjeve ne i kemi pasur edhe disa obligime të tjera që kanë të bëjnë me vaksinimin e sportistëve për të gjithë ekipin olimpik që do të udhëtojë për Lojërat Olimpikë 'Tokio 2020'. Tashmë ka përfunduar edhe pjesa e fundit, pra doza e dytë është marrë nga gjithë ekipi olimpik dhe me këtë rast dua t'i

falënderoj edhe institucionet shtetërore të Kosovës të cilat u janë përgjigjur kërkesës së Komitetit Olimpik që të vaksinohet i gjithë ekipi olimpik i Kosovës", ka deklaruar Haxhijaj. KOK-u, po ashtu, bëri me dije se banka TEB do të jetë sponsorja më e re, duke i përkrahur në rrugëtimin e tyre drejt Lojërave Olimpikë "Tokio 2020".

Tuhina: Është nder të jem pjesë e Kosovës A



PRISHTINË, 8 KORRIK - Basketbollistja 16-vjeçare Aстера Tuhina është shprehur e lumtur që do të jetë pjesë e Kosovës A. Ajo gjithashtu është pjesë e Kosovës U20 te femrat dhe do të luajë në dy turne brenda pak ditëve. "Është një ndjenjë shumë e mirë të jesh pjesë e Kosovës A. Vetë fakti që jam 16-vjeçare tregon se çfarë emocioni është të jesh pjesë e Kosovës A", ka thënë Tuhina për faqen zyrtare të FBK-së. Aстера është pjesë e klubit spanjoll Club

Deportivo Promete derisa ka folur edhe për rrjedhën e përgatitjeve dhe synimet me Kosovën A. "Ne jemi duke u përgatitur dy herë në ditë në mënyrë që të kemi një përfaqësim sa më të mirë, pasi kjo është hera e parë që garojmë me Kosovën A", ka shtuar basketbollistja e talentuar. Kosova A do të debutojë në garat ndërkombëtare në Kampionatin Evropian për Shtete të Vogla në Qipro nga 20 deri më 25 korrik. Kosova është në grup me

Luksemburgun dhe Qipron. Përveç kësaj, Aстера është edhe pjesë e Kosovës U20. "Fillimisht do të garojmë me Kosovën U20, ku shpresoj në rezultate të mira", u shpreh Aстера Tuhina. Kosova U20 (F) do të marrë pjesë në Grupin E të FIBA U20 Women's European Challengers, që do të organizohet në Shkup prej 13 deri më 18 korrik 2021. Kosova do të luajë në grup me Rumaninë, Sllovakinë, Luksemburgun dhe Maqedoninë e Veriut.

Verrati: Anglisë i dhuruan penallti bujare

LONDËR, 8 KORRIK - Italia dhe Anglia janë dy skuadrat finaliste të Kampionatit Evropian teksa do të ndeshen me njëra-tjetrën më 11 korrik. Mesfushori italian Marco Verrati ka ndezur sfidën duke

thumbuar Anglinë për sfidën ndaj Danimarkës. Mesfushori i PSG-së u shpreh se ndaj "Tre Luanëve" u dha një penallti bujare pasi në të vërtetë nuk ishte. "E pamë të gjithë ndeshjen e Anglisë dhe

Danimarkës dhe nëse do të kisha qenë gjyqtar nuk do ta kisha dhënë penalltinë. Unë mendoj se ishte një penallti 'bujare', por janë pjesë e futbollit dhe mund të ndodhin. Sidoqoftë, në sfidën e të dielës mendojmë

se do të zgjidhet një gjyqtar i shkëlqyeshëm, një i mësuar me Ligën e Kampionëve dhe ndeshje të rëndësishme dhe që nuk e lë veten të ndikohet, kështu që nuk kemi frikë për këtë", ka thënë Verrati.



Hjulmand: E mahnitshme ajo që ka bërë Danimarka në 'Euro 2020'

LONDËR, 8 KORRIK - Danimarka luftoi fort, por në fund humbi nga Anglia (2-1) pas 120 minutash në "Wembley", duke u eliminuar nga "Euro 2020". "Padyshim që ka zhgënjim të madh sepse ishim aq afër finales.

Duhet ta hidhnim hapin e fundit në rrethana të ndryshme gjatë ndeshjes. Ka qenë e mahnitshme ajo që skuadra ka bërë. Ka cilësi dhe fuqi të madhe brenda djemve. Ata kanë luajtur në mënyrë fantastike. Kemi

sulmuar, duke shënuar gola dhe e kemi treguar veten tonë. Lojtarët kanë bërë gjithçka, si brenda edhe jashtë fushës. Qëndruam së bashku dhe luftuam deri në minutën e fundit", ka thënë Kasper

Hjulmand, trajner i Danimarkës. "Tani jemi tepër të zhgënjyer, por nuk do të vonojë shumë që do të kthehemi dhe do të themi: ne i dhamë një të shtyrë dhe tani do t'i shkojmë sërish deri në fund", ka shtuar Hjulmand.



Southgate: E ndjeva se do të shkonim në finale, Italia është në formë të jashtëzakonshme

LONDËR, 8 KORRIK - Gareth Southgate ka festuar shumë, pasi Anglia për herë të parë në histori u kualifikua në një finale Evropiane. "Tre Luanët" fituan në shtesë me rezultatin 2-1 kundër Danimarkës. "Jam shumë krenar për lojtarët. Ishte një rast i jashtëzakonshëm për të qenë pjesë e historisë. Tifozët ishin të pabesueshëm gjatë gjithë mbrëmjes. E ndjeva se do të shkonim në finale, por e dija se do të kishim një betejë tjetër. Danimarka është aq e nënvlerësuar si ekip dhe ne na shkaktoi shumë telashe. Penalltia e Kane? Askush nuk do të ndodhë ashtu, por ishte kundër një portieri të shkëlqyeshëm. Fatmirësisht shënoi", ka thënë Southgate. "Duhet ta shijojmë faktin që jemi në finale, por ka një pengesë të madhe përpara për të fituar. Italia është një ekip shumë i mirë në dy vjetët e fundit. Është në formë të jashtëzakonshme dhe ka mbrojtës luftëtarë që kanë kaluar



gjithçka. Është një ndeshje e madhe që na pret. Finalet janë për t'u fituar. Do të rigrupohemi dhe do të përgatitemi siç duhet. Duhet të rikuperohejmë direkt, pasi jemi

konsumuar shumë fizikisht dhe mendërisht. Italia, gjithashtu, ka kaluar një situatë të tillë, edhe pse ka një ditë më shumë për t'u rikuperuar", ka shtuar Southgate.

SHKURT

UEFA hap hetim disiplinor ndaj Anglisë

UEFA ka hapur një procedurë disiplinore ndaj Anglisë pas gjysmëfinales kundër Danimarkës që u luajt të mërkurën në mbrëmje. Nën akuzë janë disa tifozë të cilët kanë përdorur laser kundër Peter Schmeichel në momentin e ekzekutimit të penalltisë nga Kane. Një veprim i ngjashëm është bërë edhe gjatë ekzekutimit të himnit të Danimarkës, ndërkohë që janë përdorur edhe fishekzjarrë. Federata Angleze mund të marrë një gjobë për shkak të shkeljes së rregullave.

Sterling: Penalltia ishte e qartë

Raheem Sterling u shpreh i lumtur pasi Anglia arriti në finalen e Kampionatit Evropian për herë të parë që nga viti 1966, me një fitore ndaj Danimarkës. "Ishte një performancë e lartë. Na u desh të gërmonim thellë. Ishte hera e parë që ne kemi qenë në disavantazh, por arritëm të rikthehemi", ka thënë Sterling. Ai u iku pyetjeve rreth penalltisë së dyshimtë pas 102 minutash, por ka thënë se kontakti i bërë nga Joakim Maelhe brenda zonës ishte "një penallti e qartë".

Pedri: Spanja kthehet më e fortë

Futbollisti i Barcelonës, Pedri, ka thënë se Spanja do të rikthehet më e fortë dhe ka histori për të bërë. Spanja u eliminua në gjysmëfinale nga Italia, pas ekzekutimit të penalltive. "Pavarësisht se fundi ishte zhgënjyes, përvoja e këtyre javëve të fundit ka qenë e paharrueshme. Faleminderit nga zemra të gjithë atyre që e bënë të mundur këtë, mbi të gjitha shokëve të skuadrës dhe trajnerëve! Dua të falënderoj edhe tifozët për mbështetjen e madhe që na kanë dhënë. Ne do të rikthehemi më të fortë", ka thënë Pedri.

Locatelli preferon Juventusin para Arsenalit

E ardhmja e Manuel Locatellit duket se do të jetë te Juventus. Sipas "Tuttosport", mesfushori i Sassuolos ka bërë të qartë dëshirën e tij për t'u transferuar në Torino. Një qëndrim ky që ka nxjerrë nga gara Arsenalin, një nga skuadrat që ishte hedhur në sulm për ish-yllin e Milanit. "Topçinjtë", në fakt, duket se kanë kthyer vëmendjen nga Housseem Aouar i Lyonit. Për sa iu takon negociatave mes Juventusit dhe Sassuolos, drejtuesit bardhezinj duket se po punojnë për një formulë të ngjashme me atë që ka çuar Chiesan nga Firenze në Torino. Formula është një huazim për një shifër të ulët dhe detyrimin e blerjes për një shumë të konsiderueshme.

Ramosi prezantohet te PSG-ja

Paris, 8 korrik - Mbrojtësi Sergio Ramos i është bashkuar Paris Saint-Germainit në një marrëveshje dyvjeçare, e cila do ta mbajë atë në Paris deri më 2023. Lajmi e ka dhënë vetë klubi francez. Ramos iu bashkua gjigantit parisien si lojtar i lirë, pasi kontrata me Real Madridin i kishte mbaruar më 1 korrik. "PSG-ja njofton me kënaqësi ardhjen e Sergio Ramosit. Qendërmbrojtësi spanjoll ka nënshkruar marrëveshje dyvjeçare, që do ta mbajë atë në klub deri më 30 qershor 2023", thuhet në njoftimin e PSG-së. Ndërsa mbrojtësi spanjoll është shprehur i lumtur se ka nënshkruar me një klub siç është PSG-ja dhe ka premtuar që do ta ndihmojë klubin parisien që të fitojë trofe. "Jam shumë i lumtur që u bashkova me Paris Saint-Germainin. Është një ndryshim i madh në jetën time, një sfidë e re dhe një ditë që nuk do ta harroj kurrë. Jam krenar që jam pjesë e këtij projekti shumë ambicioz, për t'u bashkuar me një ekip me lojtarë të shkëlqyeshëm. Është një klub që tashmë është dëshmuar në nivelin më



të lartë me baza të forta. Unë dua të vazhdoj të rritem me Parisin dhe ta

ndihmoj ekipin të punojë për të fituar tituj", ka thënë Ramos.

PSG-ja synon edhe transferimin e Pogbas


Paris Saint Germain nuk ka ndërmend të ndalet në merkato dhe pasi ka kompletuar katër afrime të bujshme Donnarumma, Wijnaldum,

Hakimi, Sergio Ramos do të provojë të sjellë në "parkun e princave" edhe mesfushorin Paul Pogba. "L'Equipe" raporton se drejtuesit e PSG-së kanë folur

me Mino Raiolën për mundësinë e transferimit të Pogbas në Francë dhe kanë marrë informacione nga ky i fundit se marrëveshja mund të

mbyllet për shifrën e 80 milionë eurove, duke qenë se Manchester Unitedi dëshiron ta shesë këtë verë, për të mos e humbur me parametra zero

verën e ardhshme. Ndërkohë nga PSG-ja pritet të largohen Rafinha, Icardi, Paredes, Sarabia, Herrera, Diallo, Kurzaëa dhe Kehrer.





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjejpuneshpejte


RESTAURANT

SWISS

TAVERNA


Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553


PRISHTINË





Lume's Details


Estetik & Depilim

 044 900 978 | 045 687 898


 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



Njoftim për tatimpagues

Mos bëj transaksione me biznese fiktive dhe biznese jo-aktive!

Administrata Tatimore e Kosovës, rikujton të gjitha bizneset, të cilat merren me aktivitete afariste, se në bazë të legjislacionit tatimor, ATK nuk njihet transaksionet e realizuara me biznese fiktive dhe biznese jo-aktive.

Transaksionet e realizuara me biznese fiktive dhe biznese jo-aktive, gjegjësisht shpenzimet në Deklaratën e Tatimit në të Ardhura, si dhe kërkesat për kreditim të zbritshëm në një deklaratë të TVSH-së, nuk do të njihen nga ATK.

Njëherësh, ATK, ju njofton se aktivitetet e saj, do të përqendrohen te bizneset, të cilat zhvillojnë transaksione fiktive dhe biznese jo-aktive që funksionojnë në mënyrë jo të rregullt, për të cilat do të ndërmerren masat ndëshkuese konform legjislacionit tatimor.

ATK, ju bën thirrje të gjitha bizneseve, që para se të hyjnë në transaksione afariste të bëjnë verifikimin e bizneseve jo-aktive, të cilat i gjeni në ueb faqe www.atk-ks.org në linkun <http://www.atk-ks.org/non-active-taxpayers/>.

Është detyrë e çdo tatimpaguesi që të respektoj dhe të zbatoj dispozitat e legjislacionit tatimor të aplikueshëm.

Me kryerjen e detyrimeve tuaja tatimore, ju kontribuoni direkt në ofrimin e shërbimeve publike, arsimim me standarde të larta, shërbime më të mira shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie të qëndrueshme ekonomike dhe shoqërore.

Administrata Tatimore e Kosovës

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Jetmir Uka shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së dhjetë të shkollës së mesme "Sami Frashëri" Prishtinë.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

